



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.19/2026**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e partisë politike Alternativa, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Nr. 01/335-2026 i datës 26.02.2026 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos përfshirjes në caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2026, merr këtë;

## **V E N D I M**

**Hedhet poshtë e palejuar** ankesa e parashtruar nga Partia Politike Alternativa, me seli në Prishtinë paraqitur kundër vendimit nr. 01/335-2026 i datës 26.02.2026 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos përfshirjes në caktimin e lartësisë së mjeteve nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike për partinë politike Alternativa

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datën 04.03.2026 ka pranuar ankesën Anr.19/2026 e cila është dorëzuar nëpërmjet Postes së Kosovës me datën 28.02.2026 nga Partia Politike Alternativa, me seli në Prishtinë të paraqitur kundër vendimit nr. 01/335-2026 i datës 26.02.2026 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në të cilën pretendon se KQZ-ja ka bërë shkeljen e Ligjit mbi financimin e Subjekteve Politike Ligji nr.03/L-174, neni 9 pika 1 dhe neni 10, pasi që partia politike Alternativa ka fituar në zgjedhjet e datës 28 dhjetor 2025 me një mandat për deputet. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë drejtim në bazë të Ligjit të lartpërmendur i takon përkrahje financiare, gjë e cila deri në këtë kohë nuk ka ndodhë. Më tutje thekson se vendimi i KQZ-se me nr. 01/335-2026 i datës 26.02.2026 nuk ka përfshirë Partinë Alternativa në caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e Subjekteve politike në rastin konkret të Alternatives, dhe thekson se ky vendim është në kundërshtim me ligjin.

Në përgjigjen në ankesë të KQZ-së lidhur me pretendimet e partisë politike Alternativa theksojnë se financimi i subjekteve politike bëhet përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, fondit për mbështetjen e subjekteve politike, Fondi për mbështetjen e subjekteve politike funksionin në kuadër të KQZ-së. Sipas paragrafit të nenit 9 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, përcaktohet se për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjektit

politik, mjetet nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike, ndahen në mes subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit ulëseve për mandat. Ndërsa, në piken 6 të Ligjit Nr.08/122 ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/ L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122 si dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03/L-256, përcaktohet se "Në rast të koalicionit, shpërndarja e fondeve do të bëhet në bazë të numrit të deputetëve që përfaqësojnë secilën parti politike brenda koalicionit dhe fondet i shpërndahen drejtpërdrejt partive politike, përfshirë rastet edhe pas pushimit ekzistimit të koalicionit. Për identifikimin e saktë të deputetëve secilës parti politike pjesë e koalicionit, bashkëngjitur me dokumentacionin për aplikim për certifikim të koalicionit, lista e kandidatëve të dorëzuar duhet të përmbajë përkatësinë partiake për secilën parti politike pjesë të koalicionit. Në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28.12.2026 KQZ sipas vendimin me numër 01/235-2026 i datës 09.02.2026 ka certifikuar rezultatet përfundimtare për këto zgjedhje ku 15 subjekte politike kanë fituar ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës përfshirë edhe koalicionin parazgjedhor Lëvizja Vetëvendosje ku në kuadër të këtij koalicioni ulëse kanë fituar 3 parti politike të regjistruara pjese e këtij koalicioni. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 3 të Rregullores Nr. 06/2024 për Menaxhimin e Financave publike të subjekteve politike, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve politike (Zyra) ka rekomanduar KQZ-në mjetet financiare nga fondi për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Zyra ka bërë përllogaritjen e ndarjes së fondit duke u bazuar në gjendjen aktuale datës ku është përgatitur rekomandimi në bazë të ndarjes së vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës derisa në të kaluarën formula e ndarjes është bazuar në rezultatet e certifikuar. Pas certifikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 28.12.2025 me qëllim të ndarjes së fondit ka përfshirë 16 subjekte politike.

Sipas rezultatit të certifikuar partia politike Alternativa e cila pjesë e koalicionit Lëvizja Vetëvendosje ka fituar një (1) ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpo deputetja që ka fituar ulësen e ka liruar mandatin e deputetes pasi që është e emëruar Ministre në Qeverinë e Kosovës si rezultat është zëvendësuar nga kandidati i radhës nga lista e kandidatëve që ka fituar më së shumti ulëse, e që nuk ka rezultuar të jetë nga kandidatet e partisë politike Alternativa po nga kandidatët e partisë politike Lëvizja Vetëvendosje. Si rezultat i kësaj partia politike Alternativa, tash ka mbetur pa përfaqësim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Siç u theksua më lart legjislacioni në fuqi nuk përcakton deklarativisht se ndarja e mjeteve nga fondi duhet të bëhet sipas rezultatit të certifikuar apo në bazë të shpërndarjes aktuale të ulëseve në Kuvend në momentin e ndarjes së fondit. Megjithëse sipas ligjit në rast të koalicionit shpërndarja e fondeve do të bëhet në bazë të numrit të deputetëve që përfaqësojnë secilën parti politike brenda koalicionit dhe fondet i shpërndahen drejtpërdrejt partive politike përfshirë rastet edhe pas pushimit të ekzistimit të koalicionit. Në lidhje me këtë me qëllim të identifikimit të saktë të deputeteve të secilës parti politike që është pjesë e koalicionit, kërkohet bashkëngjitja e dokumentacionit për aplikim për certifikim të koalicionit, ku lista e kandidatëve duhet të përmbajë përkatësinë partiake për secilën parti politike pjesë e koalicionit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se ankesa është e **pa lejuar**.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu është referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 1 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, ndërsa paragrafi 3 i këtij ligji përcakton se: “PZAP-ja vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.” Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9 dhe paragrafi 1 dhe paragrafi 5 të këtij neni, të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me të cilin është përcaktuar “Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtrojë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LZP-së ose rregullave zgjedhore.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, përkatësisht, vendimi i KQZ-së për ndarjen e mjeteve nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike, në këtë kuptim, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesa është e palejueshme.

Prandaj, nga arsyet e theksuar më lartë, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 115 paragrafi 1, dhe nenit 119 paragrafi 3, të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën të pa lejueshme.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.19/2026 më datën 06.03.2026



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME



AA.nr.17/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Milena Derić anëtarë të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik: Partia Politike Alternativa, me seli në Prishtinë, për shkak të mospërfshirjes në caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, për ulëset e fituara në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.19/2025, të datës 06.03.2026, në seancën e mbajtur më datë 12.03.2026, merr këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Partia Politike Alternativa, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.19/2025, të datës 06.03.2026.

#### A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.19/2025, të datës 06.03.2026, është vendosur: Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e parashtruar nga Partia Politike Alternativa, me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr. 01/335-2026, i datës 26.02.2026 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos përfshirjes në caktimin e lartësisë së mjeteve nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike për Partinë Politike Alternativa.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik Partia Politike Alternativa, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës që të: Aprovojë ankesën e parashtruar pranë kësaj gjykate, të anulojë Vendimin e PZAP-së Anr.19/2025, të datës 06.03.2026, të shpallë të kundërligjshëm vendimin e KQZ Nr. 01/335-2026, në pjesën që nuk përfshin partinë politike Alternativa në ndarjen e Fondit për Subjektet Politike dhe të Obligojë KQZ-në që të p...



partinë politike Alternativa në ndarjen e mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, në përputhje me rezultatin e certifikuar të zgjedhjeve.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe i propozon Gjykatës Supreme që ankesën e datës 10.03.2026, nga ankuesi subjekti politik Partia Politike Alternativa, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr.19/2025, të datës 06.03.2026, të refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e ankimuar të PZAP.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më PZAP-i, më datën 04.03.2026, ka pranuar ankesën Anr. 19/2026, e cila është dorëzuar nëpërmjet Postës së Kosovës me datën 28.02.2026 nga Partia Politike Alternativa, me seli në Prishtinë. Ankesa është paraqitur kundër vendimit nr. 01/335-2026, të datës 26.02.2026 të KQZ-së, në të cilën pretendon se KQZ-ja ka shkelur Ligjin mbi financimin e subjekteve politike (Ligji nr. 03/L-174, neni 9 pika 1 dhe neni 10), pasi partia Alternativa ka fituar një mandat për deputet në zgjedhjet e datës 28 dhjetor 2025. Parashtruesi thekson se sipas ligjit i takon përkrahje financiare, e cila deri më tani nuk ka ndodhur. Më tej, thekson se vendimi i KQZ-së me nr. 01/335-2026 i datës 26.02.2026 nuk ka përfshirë Partinë Alternativa në caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike dhe është në kundërshtim me ligjin.

Në përgjigjen në ankesë të KQZ-së lidhur me pretendimet e partisë politike Alternativa, theksohet se: financimi i subjekteve politike bëhet përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, fondit për mbështetjen e subjekteve politike. Fondi për mbështetjen e subjekteve politike funksionon në kuadër të KQZ-së. Sipas paragrafit të nenit 9 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, përcaktohet se për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjektit politik, mjetet nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike ndahen në mes subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, në bazë të numrit të ulëseve për mandat. Ndërsa, në pikën 6 të Ligjit Nr. 08/122, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122, si dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, përcaktohet se: *“Në rast të koalicionit, shpërndarja e fondeve do të bëhet në bazë të numrit të deputetëve që përfaqësojnë secilën parti politike brenda koalicionit, dhe fondet i shpërndahen drejtpërdrejt partive politike, përfshirë rastet edhe pas pushimit të ekzistimit të koalicionit. Për identifikimin e saktë të deputetëve secilës parti politike pjesë e koalicionit, bashkëngjitur me dokumentacionin për aplikim për certifikim të koalicionit, lista e kandidatëve të dorëzuar duhet të përmbajë përkatësinë partiake për secilën parti politike pjesë të koalicionit.”* Në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28.12.2025, KQZ sipas vendimit me numër 01/235-2026 i datës 09.02.2026 ka certifikuar rezultatet përfundimtare për këto zgjedhje, ku 15 subjekte politike kanë fituar ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe koalicionin para zgjedhjeve.



Vetëvendosje, ku në kuadër të këtij koalicioni ulëse kanë fituar 3 parti politike të regjistruara pjesë e këtij koalicioni.

Ka shtuar se: Bazuar në paragrafin 3 të nenit 3 të Rregullores Nr. 06/2024 për Menaxhimin e Financave Publike të Subjekteve Politike, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) ka rekomanduar KQZ-së mjetet financiare nga fondi për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Zyra ka bërë përlllogaritjen e ndarjes së fondit duke u bazuar në gjendjen aktuale, datës ku është përgatitur rekomandimi në bazë të ndarjes së vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, derisa në të kaluarën formula e ndarjes ishte bazuar në rezultatet e certifikuara. Pas certifikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 28.12.2025, me qëllim të ndarjes së fondit, ka përfshirë 16 subjekte politike. Sipas rezultatit të certifikuar, Partia Politike Alternativa, e cila është pjesë e koalicionit Lëvizja Vetëvendosje, ka fituar një (1) ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mirëpo, deputetja që ka fituar ulësën e ka liruar mandatin e deputetes pasi që është e emëruar Ministre në Qeverinë e Kosovës, si rezultat është zëvendësuar nga kandidati i radhës nga lista e kandidatëve që ka fituar më së shumti ulëse, dhe që nuk ka rezultuar të jetë nga kandidatët e Partisë Politike Alternativa, por nga kandidatët e Partisë Politike Lëvizja Vetëvendosje. Si rezultat i kësaj, Partia Politike Alternativa tash ka mbetur pa përfaqësim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Siç u theksua më lart, legjislacioni në fuqi nuk përcakton deklarativisht se ndarja e mjeteve nga fondi duhet të bëhet sipas rezultatit të certifikuar apo në bazë të shpërndarjes aktuale të ulëseve në Kuvend në momentin e ndarjes së fondit. Megjithatë, sipas ligjit, në rast të koalicionit, shpërndarja e fondeve bëhet në bazë të numrit të deputetëve që përfaqësojnë secilën parti politike brenda koalicionit, dhe fondet i shpërndahen drejtpërdrejt partive politike, përfshirë rastet edhe pas pushimit të ekzistimit të koalicionit. Në lidhje me këtë, me qëllim të identifikimit të saktë të deputetëve të secilës parti politike që është pjesë e koalicionit, kërkohet bashkëngjitja e dokumentacionit për aplikim për certifikim të koalicionit, ku lista e kandidatëve duhet të përmbajë përkatësinë partiake për secilën parti politike pjesë e koalicionit.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin Anr.19/2025, të datës 06.03.2026, me të cilën e ka hedhur si të palejueshme ankesën e subjektit politik ankues: Partia Politike Alternativa, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimit.

Në arsyetim të vendimit ka theksuar se: Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu është referuar Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenit 119 paragrafi 1 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtën e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore.”* Ndërsa paragrafi 3 i këtij ligji përcakton se: *“PZAP-ja vendos për të shqyrtuar ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj”*. Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesa është specifikuar me



nenet 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9 dhe paragrafi 1 dhe paragrafi 5 të këtij neni, të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me të cilin është përcaktuar: *“Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtrorjë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtë e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LZP-së ose rregullave zgjedhore.”*

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozitë ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, përkatësisht vendimi i KQZ-së për ndarjen e mjeteve nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike. Në këtë kuptim, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hyn në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, dhe rrjedhimisht ankesa është e palejueshme.

Nga arsyet e theksuar më lart, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 115 paragrafi 1 dhe nenit 119 paragrafi 3 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e subjekti politik: Partia Politike Alternativa. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, ndryshim - plotësimeve të tij, dhe Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Partia Politike Alternativa kishte fituar një mandat në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 28.12.2025, brenda koalicionit parazgjedhor Lëvizja Vetëvendosje. Deputetja e partisë Alternativa që kishte fituar ulësen ishte emëruar Ministre, dhe mandati i saj, ishte zëvendësuar nga kandidati tjetër nga lista e koalicionit, i cili nuk ishte pjesë e Alternativës. Si pasojë, nuk ishte përfshirë në vendimin nr.01/335, të datës 26.02.2026, mbi caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, për periudhën 11 shkurt 2026 deri më 31 dhjetor 2026.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës, ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkitazi me: Ankuesja pretendon se ka fituar një mandat deputeti në zgjedhjet parlamentare dhe për këtë arsye duhet të përfshihet në ndarjen e fondeve për subjektet politike, sipas Ligjit Nr. 03/L-174. Mos përfshirja e saj sipas saj përbën shkelje të drejtës për trajtim të barabartë dhe cenim të të drejtave ligjore. Po ashtu, pretendon se PZAP ka vepruar gabim kur e ka refuzuar ankesën, duke interpretuar në mënyrë restriktive



juridiksionin e tij dhe duke kufizuar të drejtën e ankimit për vendimet e KQZ-së që prekin të drejtat e subjekteve politike dhe se kjo shkelje cenon të drejtën e saj kushtetuese për të përdorur mjete juridike kundër vendimeve që prekin të drejtat ose interesat e saj ligjore të garantuara me nenin 32 të Kushtetutës, si dhe se mos përfshirja e saj në ndarjen e fondeve krijon trajtim të ndryshëm për subjektet politike që kanë fituar ulëse në Kuvend, cënon parimin e barazisë para ligjit dhe sigurinë juridike.

Në lidhje me këtë, me nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtën e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore.”* Ndërsa paragrafi 3 i këtij ligji përcakton se: *“PZAP-ja vendos për të shqyrtuar ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj”.* Ndërsa me nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, me të cilën përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtojë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LZP-së ose rregullave zgjedhore. 5. Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara (...), listuar taksativisht sikurse në rregullore.*

Duke pasur parasysh përcaktimin ligjor si në nenin 119 par.3, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, se PZAP vendos për të shqyrtuar ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj, kolegji i kësaj gjykate vlerësoj se ky ligj ka përcaktuar shprehimisht rastet kur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mund të parashtrohet ankesë dhe atë në nenet: 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1 të tij.

Bazuar në këto dispozita ligjore, PZAP ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ato ankesa që lidhen drejtpërdrejt me: certifikimin e listave të kandidatëve, shkeljet e Kodit të Sjelljes gjatë fushatës dhe ditës së zgjedhjeve, mos emërimin e anëtarëve të komisioneve, çështjet e vendotimeve, dhe disa çështje procedurale të numërimit dhe konfirmimit të aplikimeve. Ankesa për vendime të tjera të KQZ-së që nuk hyjnë në këto kategori, si ndarja e fondeve për subjektet politike, nuk hyjnë në juridiksionin e PZAP-it.

Gjykata po ashtu, ju referua edhe Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të datës 21 tetor 2010, dhe ndryshim - plotësimeve të mëvonshme, përkatësisht Ligjit Nr. 04/L-058, të datës 12 janar 2012, Ligjit NR. 04/L-212, të datës 23 gusht 2013, dhe Ligjit NR. 08/L-122, të datës 05 shtator 2022.

Në këtë aspekt, Gjykata shqyrtoj dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të datës 21 tetor 2010 si tërësi, i cili rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës, dhe gjykata gjeti se: në asnjërin nga dispozitat e këtij ligji nuk është paraparë e drejta e ankesës kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për çështjet të cilat janë të rregulluara me këtë ligj.



Ndërsa, sipas Ligji Nr. 04/L-058 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike, përkatësisht me nenin 7 të tij ndryshohet dhe plotësohet neni 21 par.6 i ligjit bazik, në atë mënyrë që përcaktohet se: *“6.Subjektet Politike kanë të drejtë ankese ndaj dispozitave ndëshkimore. Ankesat i drejtohen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në bazë të legjislacionit në fuqi.”*

Gjykata Supreme e Kosovës, duke pasur parasysh dispozitat ligjore në fuqi, vlerëson se ligjvënësi ka bërë ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, vetëm lidhur me dispozitat ndëshkimore, duke përcaktuar shprehimisht se kundër tyre lejohet ankesa. Bazuar në këtë, Gjykata konstaton se Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka vepruar drejt duke hedhur si të palejuar ankesën e subjektit politik ankues, pasi ligji nuk ka paraparë ndonjë të drejtë të ngjashme për ankesa kundër vendimeve të KQZ-së për ndarjen e fondeve.

Lidhur me pretendimet e subjektit politik, se i është mohuar e drejta e ushtrimit të mjetit efektiv juridik, gjykata thekson se kjo e drejtë edhe më tej mbetet e garantuar, përveç se e njëjta duhet të paraqitet në formë tjetër. Duke pasur parasysh se vendimi i KQZ-së për ndarjen e fondeve është akt përfundimtar, subjekti politik ka të drejtë të ushtrimit të padisë në gjykatë për mbrojtjen e të drejtave të tij, në përputhje me dispozitat e tjera ligjore që lejojnë kontroll juridik mbi aktet përfundimtare të organeve publike.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës, por megjithatë vlerësoj se të njëjtat janë pretendime që i referohen aspekteve meritore të cilat PZAP-i nuk i ka vlerësuar me të drejtë, sepse secila ankesë fillimisht ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë, dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pa afatshme, PZAP-i e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje të ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk do të mund të shqyrtoheshin dhe ekzaminoheshin meqenëse aspekti i lejueshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.17/2026, datë 12.03.2026

Kryetar i kolegjit,  
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Orlaščeni Adnik